

VENDIM
Nr. 210, datë 21.3.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1147, DATË 25.11.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË
DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Korrigjimin e masës përfundimtare të dëmshpërblimit financiar, të përcaktuar në vendimin nr. 1147, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, sipas anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha